

# DITARI MUJOR GUSHT 2024

## HAPET THIRRJA PËR PROJEKTE PËR FILMA ARTISTIKË ME METRAZH TË GJATË

Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hapur thirrjen për mbështetjen financiare të projekteve për filma artistikë me metrazh të gjatë dhe për projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë për koproduksion në pakicë. Producentët në konkurim, duhet të jenë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për vitin kalendarik 2024, ndërsa afati i fundit për depozitim të projekteve do të jetë data 6 shtator 2024, ora 14.00.

## MINISTRI I MEKI, BLENDI GONXHJA NË FORUMIN E SIGURISË NË PRAGË, TAKIM DHE ME PRESIDENTEN E KE



Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja mori pjesë në forumin e sigurisë GLOBSEC në Pragë, ku të pranishëm ishin liderët nga e gjithë Evropa dhe Rajoni.

Gjatë kësaj vizite zyrtare, sëbashku me Kryeministrin Edi Rama dhe Ministrin e Financave Petrit Malaj, u zhvillua edhe një takim pune me Presidenten e saporizgjedhur të Komisionit Europian, Ursula von der Leyen.

Temë kryesore e bisedës ishte Plani i Rritjes së Ballkanit Perëndimor për Shqipërinë, tashmë drejt konkretizimit, si dhe progresi ekonomik e politik në rajon, bazuar mbi piketat e rrugës europiane. Delegacioni shqiptar u ndodh në Pragë në kuadër të edicionit të 19-të të GLOBSEC. Në këtë forum sigurie ku pjesëmarrës ishin udhëheqës dhe ekspertë, u diskutuan çështjet kritike për sigurinë dhe mbrojtjen, rolin e teknologjisë dhe të AI mbi situatën gjeopolitike, në aktualitetin e luftës në Ukrainë dhe ndikimet në të ardhmen e Europës.

## MEKI ÇEL FOND INVESTIMI PËR ARSIMIN PROFESIONAL

Përmes një Akti Normativ, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, çel fondin për investim në 8 Shkolla Profesionale dhe 2 Qendra të Formimit Profesional.

Lajmi u bë i ditur nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja, i cili tha se ndërhyrjet e planifikuara do të përfshijnë rikonstrukcionin e ndërtesave ekzistuese dhe krijimin e ambienteve shtesë për disa prej tyre, duke siguruar kushte dhe standarde më të larta për arsimin profesional.

Përveç infrastrukturës së përmirësuar, më shumë se 5,000 nxënës do të kenë mundësi të përfitojnë edhe laboratorë të pajisur me

teknologjinë më të fundit dhe hapësirat e reja të dedikuara për zhvillimin e aftësive profesionale.



## 6.25 MILIONË € PËR PARKUN ARKEOLOGJIK TË BYLISIT, DO KTHEHET NË QENDËR VIZITORËSH



Një grant me vlerë 6.25 milionë Euro, u miratua nga qeveria për Menaxhimin e Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe Klosit (2024-2029). Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja, tha se ky grant është më i madhi i miratuar për një sit arkeologjik dhe pritet që të shërbejë për qendër vizitorësh, muze, vende të reja pune, infrastrukturë prezantimi, konservimi trashëgimie dhe mjedisi.

Të shumta do të jenë aktivitetet e parashikuara në këtë plan menaxhimi në funksion të ruajtjes dhe restaurimit të pasurisë arkeologjike por edhe të nxitjes së ekonomisë lokale në dobi të komunitetit dhe turizmit kulturor. Plani përfshin dhe vijimin e hulumtimeve dhe gërmimeve arkeologjike si edhe investime në punime civile e rrugë aksesi.

## RRITEN ME 10.1% PRAKTIKAT DYPALËSHE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE JASHTË VENDIT

Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve shqiptarë që punojnë dhe jetojnë jashtë vendit, mbetet një nga prioritetet e punës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Janë 761 praktika që u zbatuan për periudhën janar-qershor 2024 nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore sa i takon marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i praktikave ka shënuar rritje me 10.1%.

## SHPALLET THIRRJA PËR PROJEKTE PËR PJESËMARRJE NË BIENALEN E VENECIAS 2025

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, shpall thirrjen për paraqitjen e projekteve për tu bërë pjesë e pavijonit shqiptar në Bienalen Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia 2025.

Për të qenë pjesë e Bienales së Venecias, me qëllim prezantimin në ekspozitat në pavijonet në Giardini dhe Arsenale, si dhe në qendrën historike të Venecias, kandidatët duhet të jenë studio arkitekturore apo ekipe multidisiplinare të cilët kanë në përbërje të tyre arkitektë (drejtues i grupit), artistë, graphic designer, kritikë arti, artizanë, sociologë urbanë, planifikues urbanë etj. Gjithashtu ata duhet të dëshmojnë njohuri shumë të mira mbi arkitekturën shqiptare dhe të kenë përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arkitekturës, arkitekturës eko-miqësore, urbanistikës dhe peizazhit e cila të dëshmohet përmes portofoleve të punimeve. Ekspozita e 19-të Ndërkombëtare e Arkitekturës me temë “Intelligens. Natyrale. Artificiale. Kolektive”, do të jetë e hapur për publikun në periudhën 10 maj - 23 nëntor 2025.



## KREDI TË BUTA PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme tashmë kanë një mundësi të artë për të çuar përpara punën e tyre, falë programit italo - shqiptar “PRODAPS”, që synon t’i mbështesë me kredi të buta dhe interes të ulët. Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja tha se me qëllim lehtësimin e aksesit në kredi dhe për të ndihmuar kompanitë të shfrytëzojnë sa më mirë linjën e kredisë, ky program ofron edhe një fond garancie dhe asistencë teknike. Me anë të këtij programi, nxitet edhe rritja dhe inovacioni, duke përmirësuar aftësitë teknologjike dhe qasjen në financim për SME-të.

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E ARTIT, KULTURËS DHE EKONOMISË KRIJUESE



Një marrëveshje e rëndësishme për bashkëpunim në fushën e artit, kulturës dhe ekonomisë krijuese për periudhën 2024-2027, partneriteti i cili do të përfshijë projekte dhe aktivitete që mbështesin ekonominë krijuese të Shqipërisë, u nënshkrua midis Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të Shqipërisë dhe British Council.

Ky memorandum bashkëpunimi do të sjellë përvojën dhe ekspertizën e Këshillit Britanik për zhvillimin e qendrave dhe programeve kreative të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e ekonomive më të qëndrueshme dhe të pasura, duke zvogëluar pabarazitë dhe nxitjen e inovacionit. Sektori i ekonomisë krijuese përfshin rreth \$2 trilion dhe krijon 50 milionë vende pune në mbarë botën, duke përfshirë shumë gra dhe të rinj. Çdo \$1 i shpenzuar krijon \$2.5 pasuri për ekonominë dhe mund të përbëjnë 2-7% të PBB-së.

## MEKI E DHE UNITED NATIONS ASSOCIATION ALBANIA BASHKËPUNIME PËR ARTIN E KULTURËN

Ka nisur mes Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe United Nations Association Albania, bashkëpunimi për studimin, përmirësimin dhe hartimin e politikave dhe mekanizmave mbështetës financues në fushën e artit dhe kulturës.

Përmes kësaj marrëveshje synohet të përmirësohen skemat e shpërndarjes së mbështetjes financiare në fushën e arteve pamore, arteve skenike, festivalet, artizanatit, trashëgimisë kulturore, etj. Fokus të veçantë do të ketë mbështetja e artistëve të rinj shqiptarë, pasurimi i kalendarit kulturor në të gjithë vendin, mbështetja e krijimtarisë, zhvillimi i rezidencave artistike, përfaqësimi kombëtar dhe diplomacia kulturore, mobiliteti artistik, mbështetja e organizatave kulturore e shumë programe të reja për të nxitur e mbështetur skenën e pavarur. Pjesë e punës janë edhe takimet dhe konsultat të titulluara “Zërat e Kulturës: Artistët flasin, institucionet dëgjojnë”.



## 71.4% E EKSPORTEVE DREJT VENDEVE TË BE! 199 MILIARD LEKË NGA JANARI NË QERSHOR

Eksportet e mallrave arritën në 199 miliard lekë në 6-mujorin e parë të vitit 2024. 71.4% e eksporteve shkojnë drejt vendeve të BE-së dhe krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje në disa eksporte që janë xeherorët, ngjyrat dhe hiri me mbi 1.1 mld lekë. Ndërsa avionët, anijet e hapësirës dhe pjesët e tyre me mbi 0.5 mld lekë. Artikuj prej gize dhe çeliku me plus 0.3 mld lekë. Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave dhe të tjera arritën në plus 0.3 mld lekë, ndërsa të tjera eksporte arritën mbi 1.7 mld lekë. Partnerët kryesorë tregtarë gjatë 6 mujorit të parë janë Italia, ku u eksportuan 28.7% e produkteve, duke u pasuar nga Turqia ku u eksportuan 8.5% të produkteve. Shteti i tretë që blen më tepër mallra nga Shqipëria është Kina, ku janë eksportuar 7.5% e produkteve. Kurse në Greqi, vendi ynë ka eksportuar 7.3% e produkteve.



## JANAR - KORRIK, SITET ARKEOLOGJIKE U VIZITUAN NGA 650 MIJË PERSONA



Sitet kulturore në të gjithë Shqipërinë kanë mirëpritur nga Janari në Korrik, 651,796 vizitorë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vizitat kanë pësuar një rritje prej 42%, ku 23% e vizitorëve janë turistë të huaj.

Pesë nga destinacionet më të vizituarat janë: Kalaja Gjirokastër me 120,723 vizitorë, Muzeu "Gjergj Kastrioti" Krujë me 90,955 vizitorë, Parku Arkeologjik Shkodër me 85,806 vizitorë, Parku Arkeologjik Butrint me 84,742 vizitorë dhe Parku Arkeologjik Apolloni me 68,469 vizitorë.

## RESTAUROHET KISHA E SHËN MËRISË NË MAMURRAS



Kisha e Shën Mërisë në Mamurras, një perlë e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kurbinut, ndërtuar rreth shekullit XI, e ku Gjergj Kastrioti e Donika thuhet se e vizitonin për meshë apo kremtimin e ceremonive fetare, është tashmë një tjetër destinacion turistik, falë projektit për rijetësimin e saj.

Ndërhyrja e bëra nga specialistët përkatës, konsistojnë në restaurimin dhe konsolidimin e mureve të kishës, restaurim i pikturës murale si dhe vendosja e një strehe metalike tek pjesa e absidës aty ku gjendet edhe piktura murale.

Ky objekt i shenjtë, një dëshmi e epokës bizantine, u restaurua pas dëmtimit nga tërmeti i vitit 2019, falë partneritetit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me EU4Culture dhe UNOPS.



## RRITET NUMRI I APLIKIMEVE PËR MARKËN TREGTARE

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale vijon të ketë një trend rritës sa i takon aplikimeve për regjistrim kombëtar të markës tregtare duke e bërë atë objektin më të regjistruar pranë DPPI. Për periudhën janar-korrik 2024, nëpërmjet portalit e-Albania, janë kryer 807 aplikime, 50.28% më shumë krahasuar me vitin 2023.

Rritje të konsiderueshme ka pasur edhe numri i patentave për shpikje të regjistruara në DPPI. Në total për periudhën janar-korrik u regjistruan 410 patenta, 57.1% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Ndërsa kërkesa për shtrirje/vlefshmërie të patentave nga Zyra Europiane e Patentave (EPO) janë regjistruar 334.

## MBI 2,500 BURSA DERI NË 7320 LEKË/MUAJ PËR TË RINJTË QË NDJEKIN SHKOLLËN PROFESIONALE

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të mbështesë me bursa deri në 7,320 lekë/muaj mbi 2,500 nxënës që ndjekin arsimin e mesëm profesional. Ministri i MEKI, Z. Blendi Gonxhja tha se mbështetje do të ketë për vajzat, nxënësit që regjistrohen në degët prioritare, nxënësit nga familjet në nevojë si dhe nxënësit që banojnë mbi 5 km larg nga shkolla profesionale. Mbështetje do të ketë edhe për ekselentët që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës në arsim profesional me notë mesatare mbi 9. Po ashtu MEKI, mbështet edhe nxënësit nga grupet e veçanta. Për të gjitha ata që dëshirojnë të përfitojnë, Gonxhja bën thirrje që të regjistrohen përmes e-Albania, në shërbimin “Regjistrim në klasë të dhjetë”.



## VIJOJNË PUNIMET PËR GJURMËT FISHTJANE NË LEZHË



Vijojnë punimet për hapësirën memoriale multifunktionale në Lezhë, ku ka lindur At Gjergj Fishta. Ky projekt i ri që po merr formë nga bashkëpunimi i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, do të ketë në përfundim hapësira të dedikuara për rezidenca artistike, për sesione krijimtarije e ekspozime, për të mikpritur artistët vendas e të huaj, e për të zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore dhe edukative, e jo vetëm.

Punimet për ngritjes e kësaj godine multifunktionale kulturore e rekreative në këtë vend sa historik, aq dhe tërheqës për peizazhin e mrekullueshëm natyror, u inspektuan nga afër edhe nga Zëvendës Ministrija e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Znj. Lira Pipa.

## MINISTRIA EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT PJESË KONFERENCËS SË AMBASADORËVE “DIPLO 2024”

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja dhe Zëvendës Ministria. Znj. Lira Pipa, ishin pjesë e Konferencës së Ambasadorëve “Diplo 2024”. Si pjesë e panelit për diplomacinë ekonomike, Gonxhja u shpreh se aktualisht MEKI po vlerëson dy strategji që mund të sjellin benefite në drejtim të investimeve të huaja direkte, ashtu edhe në zgjerimin përtej kufijve kombëtare të sipërmarrjeve më të suksesshme vendase.

Gjithashtu, Ministri bëri me dije se së shpejti do të prezantohet edhe nisma “Ditët Kulturore Shqiptare 2025”, një hap ambicioz për të forcuar lidhjet me diasporën dhe për të promovuar trashëgiminë e Shqipërisë. Ndërsa zv. ministrja Pipa, ishte pjesë e panelit të Diplomacisë Kulturore, së bashku me tre ambasadorë të shquar të artit dhe kulturës shqiptare në botë: znj. Lea Ypi, akademike dhe autore shqiptare, z. Ramë Lahaj, tenor i mirënjohur operistik dhe Profesor Matteo Mandala, studiues ietërsisë arbëreshe dhe asaj shqiptare.



## ISHPSHSH INSPEKTOI 4.6% MË SHUMË SUBJEKTE PËRGJATË MUAJVE JANAR – KORRIK

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore përgjatë muajve Janar-Korrik 2024, ka inspektuar 5923 subjekte ose mbi 4.6% më shumë krahasuar me një vit më parë për respektimin e standardeve të punës. Edhe inspektimet për ankesat janë rritur me 31%, ku 63% prej tyre rezultuan me masa administrative (pezullim, paralajmërim, gjobë). Punëmarrësit informalë të identifikuar gjatë proceseve inspektuese rezultojnë në rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë në masën 52%. Janë 1,524 punëmarrës informal të futur në skemë gjatë procesit inspektues. 33% e inspektimeve përfunduan me masa administrative, ndërsa nuk ka munguar as këshillimi për të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit të punës, ku kanë përfituar mbi 11 mijë subjekte të reja.

## 25 AKTIVITETE U MBËSHTETËN NGA “SKENA E PAVARUR” NË MUAJIN GUSHT

“Skena e Pavarur” e mbështetur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ka sjellë në çdo cep të Shqipërisë 25 aktivitete dhe ngjarje për të gjitha grupmoshat përgjatë të gjithë muajit gusht. Ndër aktivitetet e mbështetura dhe që mblodhën sëbashku mbi 35 mijë pjesëmarrës janë, festivali Porto Palermo që u mbajt nga datat 1-18 gusht në Himarë, festivali “Nona” apo festa e gjysheve shqiptare që u mbajt më 9-11 gusht, festivali Jehona e Vjosës më 16-17 gusht në Memaliaj, festa e Tamarës e zhvilluar më 18 gusht në Malësi të Madhe, rikthimi i traditës myzeqare zhvilluar më 20 gusht, mbrëmja gala me muzikë të huaj në Lin, Pogradec më 22-23 gusht dhe shumë aktivitete të tjera.

## ISHMT SHTON KONTROLLET NË TERREN, 131% MË SHUMË INSPEKTIME SE NË VITIN 2023

Në shtatë muajt e parë të vitit 2024, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka shtuar kontrollet në terren, me qëllim ndalimin e produkteve që nuk janë në përputhje me standardet e sigurisë dhe garantimin e respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Nga Janari në Korrik, ISHMT ka inspektuar 1510 subjekte ose 131% më shumë krahasuar me vitin 2023 dhe ka kontrolluar 5161 produkte ose mbi 85% dhe më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.